

TRIBUNALI PENAL NDËRKOMBËTAR PËR ISH-JUGOSLLAVINË

Lënda Nr. IT-03-66-PT

PROKURORJA E TRIBUNALIT

KUNDËR

Fatmir LIMAJT
HARADIN BALËS
Isak MUSLIUT

AKTAKUZA E NDRYSHUAR PËR TË DYTËN HERË

Prokurorja e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, në bazë të kompetencave të saj sipas Nenit 18 të Statutit të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (më tej: “Statuti i Tribunalit”) akuzon:

Fatmir LIMAJN, i njohur si Çeliku
Haradin BALËN, i njohur si Shala
Isak MUSLIUN, i njohur si Çerçizi

Për **KRIME KUNDËR NJERËZIMIT** dhe **SHKELJE TË LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS**.

TË AKUZUARIT

1. **Fatmir LIMAJ**, i njohur si Çeliku, u lind më 4 shkurt 1971 në Banjë, atëherë në komunën e Suharekës në krahinën autonome të Kosovës (“Kosovo”). Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Fatmir LIMAJ** ishte komandant në *Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës* (UÇK). Në këtë post, **Fatmir LIMAJ** ishte përgjegjës për funksionimin e zonës së Llapushnikut dhe të Kamp-Burgut të UÇK-së në Llapushnik (më tej: Kamp-Burgu i Llapushnikut”), që gjendej në komunën e Gllogocit në Kosovë.
2. **Isak MUSLIU**, i njohur si Çerçizi, u lind më 31 tetor 1970 në Reçak në komunën e Shtimes në Kosovë. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Isak MUSLIU** ishte anëtar i UÇK-së dhe komandant në zonën e Llapushnikut

dhe në Kamp-Burgun e Llapushnikut, dhe herë pas herë vepronte si rojë në Kamp-Burgun e Llapushnikut.

3. **Haradin BALA**, i njohur si Shala, u lind më 10 qershor 1957 në Koreticë të Epërme në komunën e Glllogocit në Kosovë. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Haradin BALA** ishte anëtar i UÇK-së dhe komandant/rojë në Kamp-Burgun e Llapushnikut.

PARAQITJA E FAKTEVE

4. Jo më vonë se herët në vitin 1998, pas viteve të tensionit dhe dhunës që sa vinin shtoheshin, filloi konflikti i armatosur midis forcave serbe dhe UÇK-së në Kosovë. Ky zhvillim përputhej me politikën në përgjithësi militante të UÇK-së të qëndresës aktive të armatosur kundër pushtetit serb në Kosovë.
5. Bashkë me civilë serbë, civilët shqiptarë që sipas UÇK-së refuzuan të bashkëpunonin me UÇK-në ose i rezistuan me mjete joluftarake (shpesh të cilësuar si 'bashkëpunëtorë' nga anëtarët e UÇK-së dhe më tej të permendur si 'ata që shiheshin si shqiptarë bashkëpunëtorë') u bënë objekt i kërcënimeve, burgosjes, dhunës dhe vrasjes.

PËRGJEGJËSIA PENALE INDIVIDUALE

Neni 7(1) i Statutit të Tribunalit

6. **Fatmir LIMAJ, Isak MUSLIU, dhe Haradin BALA** janë përgjegjës për krimet për të cilat akuzohen në këtë aktakuzë, në bazë të Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit, të përcaktuar si më poshtë, për planifikimin, nxitjen, urdhërimin, kryerjen ose përndryshe për ndihmë në planifikimin, përgatitjen, ose kryerjen e veprimeve ose mosveprimeve të parashtruara në këtë aktakuzë. Me përdorimin e fjalës 'kryerja' në këtë aktakuzë, Prokurorja nuk synon të nënkuptojë se të tre akuzuarit kryen fizikisht të gjitha krimet e akuzuara. 'Kryerja' në këtë aktakuzë përfshin pjesëmarrjen e të tre të akuzuarve në një projekt të përbashkët kriminal.
7. Projekti i përbashkët kriminal filloi para majit 1998 dhe vazhdoi së paku deri në gusht 1998. Qëllimi i tij ishte të bënte civilë serbë dhe ata që shiheshin si shqiptarë bashkëpunëtorë objekt të kërcënimeve, burgosjes, dhunës dhe vrasjes, në shkelje të Neneve 3 dhe 5 të Statutit të Tribunalit.
8. Krimet e permendura në këtë aktakuzë ishin brenda qëllimit të projektit të përbashkët kriminal dhe të tre të akuzuarit ishin në gjendjen shpirtërore të nevojshme për kryerjen e këtyre krimeve, ose ishin në dijeni për sistemin e trajtimit në Kamp-Burgun e Llapushnikut dhe synonin ta zhvillonin. Alternativisht, krimet e permendur në Pikat 7 deri 10 ishin pasojë e natyrshme

dhe e parashikueshme e projektit të përbashkët kriminal dhe të tre të akuzuarit ishin të vetëdijshëm se këto krime ishin rezultat i mundshëm i kryerjes së projektit të përbashkët kriminal.

9. Që projekti i përbashkët kriminal të arrinte synime e tij, të tre të akuzuarit punuan bashkërisht dhe përmes njëri-tjetrit dhe disa individëve të tjerë në projektin e përbashkët kriminal. Individët që morën pjesë në këtë projekt të përbashkët kriminal përfshinin të tre të akuzuarit, ushtarë dhe rojë të tjerë të UÇK-së në Kamp-Burgun e Llapushnikut, dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së që morën pjesë në arrestimin e civilëve serbë dhe atyre që shiheshin si shqiptarë bashkëpunëtorë. Secili pjesëmarrës ose bashkëkryes brenda projektit të përbashkët kriminal, me veprime ose mosveprime të tij ose të saj, i kontribuoi dukshëm qëllimit të përgjithshëm të projektit.
10. **Fatmir LIMAJ**, duke vepruar individualisht ose bashkërisht me anëtarë të tjerë të projektit të përbashkët kriminal, mori pjesë në projektin e përbashkët kriminal në këto mënyra:
 - a. Ai komandoi, kontrolloi, drejtoi dhe përndryshe ushtroi kontroll efektiv mbi pjesëmarrësit e tjerë të projektit të përbashkët kriminal dhe mbi funksionimin e Kamp-Burgut të Llapushnikut.
 - b. Ai planifikoi, nxiti, dhe urdhëroi arrestimin e civilëve serbë dhe të atyre që shiheshin si shqiptarë bashkëpunëtorë.
 - c. Ai planifikoi, nxiti, urdhëroi dhe mori pjesë personalisht në burgosjen e civilëve serbë dhe të atyre që shiheshin si shqiptarë bashkëpunëtorë në Kamp-Burgun e Llapushnikut. Në disa raste ai urdhëroi lirimin e të burgosurve.
 - d. Ai planifikoi, nxiti, urdhëroi dhe mori pjesë personalisht në marrjen në pyetje të civilëve serbë dhe të atyre që shiheshin si shqiptarë bashkëpunëtorë në Kamp-Burgun e Llapushnikut.
 - e. Ai planifikoi, nxiti, urdhëroi dhe mori pjesë personalisht në trajtimin brutal dhe çnjerëzor, sulmimin fizik dhe psikik, torturat dhe rrahjen e civilëve serbë dhe të atyre që shiheshin si shqiptarë bashkëpunëtorë, të burgosur në Kamp-Burgun e Llapushnikut.
 - f. Ai planifikoi, nxiti, urdhëroi dhe mori pjesë personalisht në vrasjen e civilëve serbë dhe të atyre që shiheshin si shqiptarë bashkëpunëtorë të burgosur në Kamp-Burgun e Llapushnikut.
 - g. Ai planifikoi, nxiti, dhe urdhëroi vrasjen e dhjetë civilëve shqiptarë në malet e Berishës më 26 korrik 1998 ose rreth kësaj date.
 - h. Ai planifikoi, nxiti, urdhëroi dhe mori pjesë personalisht në përpjekje për të mbajtur të fshehtë ekzistimin e Kamp-Burgut të Llapushnikut dhe ngjarjet që ndodhën atje, duke i urdhëruar të

burgosurit të mos zbulonin asgjë që dinin për Kamp-Burgun e Llapushnikut, nën kërcënimin e vdekjes.

- i. Ai nxiti dhe ndihmoi krimet e paraqitura në këtë aktakuzë, duke mos parandaluar, hetuar ose ndëshkuar krime të kryera nga vartësit e tij kundër civilëve serbë dhe atyre që shiheshin si shqiptarë bashkëpunëtorë, në mënyrë konsekuente, si edhe duke u bërë shembull me pjesëmarrjen e vet në krime të tilla.
11. **Isak MUSLIU**, duke vepruar individualisht ose bashkërisht me anëtarë të tjerë të projektit të përbashkët kriminal, mori pjesë në projektin e përbashkët kriminal në këto mënyra:
- a. Ai komandoi, kontrolloi, drejtoi dhe përndryshe ushtroi kontroll efektiv mbi ushtarë dhe rojë të tjerë të UÇK-së në Kamp-Burgun e Llapushnikut.
 - b. Ai planifikoi, nxiti, urdhëroi dhe mori pjesë personalisht në burgosjen e civilëve serbë dhe të atyre që shiheshin si shqiptarë bashkëpunëtorë në Kamp-Burgun e Llapushnikut.
 - c. Ai planifikoi, nxiti, urdhëroi dhe mori pjesë personalisht në marrjen në pyetje të civilëve serbë dhe të atyre që shiheshin si shqiptarë bashkëpunëtorë në Kamp-Burgun e Llapushnikut.
 - d. Ai planifikoi, nxiti, urdhëroi dhe mori pjesë personalisht në trajtimin brutal dhe çnjerëzor, sulmimin fizik dhe psikik, torturat dhe rrahjen e civilëve serbë dhe të atyre që shiheshin si shqiptarë bashkëpunëtorë, të burgosur në Kamp-Burgun e Llapushnikut.
 - e. Ai planifikoi, nxiti, urdhëroi dhe mori pjesë personalisht në vrasjen e civilëve serbë dhe të atyre që shiheshin si shqiptarë bashkëpunëtorë të burgosur në Kamp-Burgun e Llapushnikut.
 - f. Ai planifikoi, nxiti, urdhëroi dhe mori pjesë personalisht në përpjekje për të mbajtur të fshehtë ekzistimin e Kamp-Burgut të Llapushnikut dhe ngjarjet që ndodhën atje, duke i kërcënuar të burgosurit të mos shikonin ose të diskutonin ngjarjet që ndodhën në kamp.
 - g. Ai nxiti dhe ndihmoi krimet e paraqitura në këtë aktakuzë, duke mos parandaluar, hetuar ose ndëshkuar krime të kryera nga artësit e tij kundër civilëve serbë dhe atyre që shiheshin si shqiptarë bashkëpunëtorë, në mënyrë konsekuente, si edhe duke u bërë shembull me pjesëmarrjen e vet në krime të tilla.
12. **Haradin BALA**, duke vepruar individualisht ose bashkërisht me anëtarë të tjerë të projektit të përbashkët kriminal, mori pjesë në projektin e përbashkët kriminal në këto mënyra:

- a. Ai mori pjesë personalisht në burgosjen e civilëve serbë dhe të atyre që shiheshin si shqiptarë bashkëpunëtorë në Kamp-Burgun e Llapushnikut.
 - b. Ai mori pjesë personalisht në marrjen në pyetje të civilëve serbë dhe të atyre që shiheshin si shqiptarë bashkëpunëtorë në Kamp-Burgun e Llapushnikut.
 - c. Ai mori pjesë personalisht në trajtimin brutal dhe çnjerëzor, sulmimin fizik dhe psikik, torturat dhe rrahjen e civilëve serbë dhe të atyre që shiheshin si shqiptarë bashkëpunëtorë, të burgosur në Kamp-Burgun e Llapushnikut.
 - d. Ai mori pjesë personalisht në vrasjen e civilëve serbë dhe të atyre që shiheshin si shqiptarë bashkëpunëtorë të burgosur në Kamp-Burgun e Llapushnikut dhe mori pjesë në fshehjen e këtyre krimeve, duke varrosur kufomat.
 - e. Ai planifikoi, nxiti, urdhëroi dhe mori pjesë personalisht në vrasjen e dhjetë civilëve shqiptarë në malet e Berishës më 26 korrik 1998 ose rreth kësaj date.
 - f. Ai mori pjesë në përpjekje për të mbajtur të fshehtë ekzistimin e Kamp-Burgut të Llapushnikut dhe ngjarjet që ndodhën atje, duke i kërcënuar të burgosurit të mos shikonin ose të diskutonin ngjarjet që ndodhën në kamp.
13. Të tre të akuzuarit morën pjesë në mënyrë të vetëdijshme dhe të vullnetshme në projektin e përbashkët kriminal, duke patur të njëjtin qëllim me pjesëmarrësit të tjerë në projektin e përbashkët kriminal ose duke qenë të vetëdijshëm për pasojat e parashikueshme të arritjes së qëllimit të projektit të përbashkët kriminal. Mbi këtë bazë, ata mbajnë përgjegjësi individuale penale për krimet e tyre sipas Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit, përpos përgjegjësisë së tyre sipas të njëjtit Nen për planifikimin, nxitjen, urdhërimin, kryerjen, ose përndryshe për ndihmën e tyre në planifikimin, nxitjen, urdhërimin dhe kryerjen e këtyre krimeve.

Neni 7(3) i Statutit të Tribunalit

14. Fatmir **LIMAJ** dhe Isak **MUSLIU** gjithashtu mbajnë përgjegjësi penale për krimet për të cilat akuzohen në këtë aktakuzë si eprorë, në bazë të Nenit 7(3) të Statutit të Tribunalit.
15. Gjatë gjithë kohës lidhur me këtë aktakuzë, Fatmir **LIMAJ** dhe Isak **MUSLIU**, në pozitat e përshtuara më sipër, ushtronin komandë dhe kontroll *de jure* dhe *de facto* mbi anëtarët e UÇK-së që vepronin në Kamp-Burgun e Llapushnikut.

16. Në pozitat e përshkruara më sipër, **Fatmir LIMAJ** dhe **Isak MUSLIU** kishin autoritet për të disiplinuar dhe ndëshkuar vartësit e tyre të cilët kishin kryer shkelje të disiplinës ushtarake dhe/ose vepra të paligjshme, duke përfshirë shkelje të së drejtës humanitare ndërkombëtare.
17. **Fatmir LIMAJ** dhe **Isak MUSLIU** dinin ose kishin arsye që të dinin se krimet e akuzuara në këtë aktakuzë do të kryheshin ose ishin kryer nga vartësit e tyre dhe nuk morën masa të domosdoshme dhe të arsyeshme për të parandaluar veprime të tilla ose për të ndëshkuar kryesit e tyre.

AKUZAT E PËRGJITHSHME

18. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, ekzistonte një situatë konflikti të armatosur në Kosovë.
19. Të gjitha veprimet dhe mosveprimet e akuzuara si Krime kundër Njerëzimit ishin pjesë e një sulmi të gjerë dhe sistematik të drejtuar kundër popullatës civile serbe dhe shqiptarëve që shiheshin si bashkëpunëtorë.
20. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Fatmir LIMAJ**, **Haradin BALA**, dhe **Isak MUSLIU** ishin të detyruar t'u përmbaheshin ligjeve dhe zakoneve të luftës, duke përfshirë Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe Protokollin Shtesë II.

AKUZAT PIKAT 1 deri në 2 (BURGOSJE, TRAJTIM MIZOR)

21. Prej ose rreth majit 1998 deri në ose rreth 26 korrikut 1998, në komunat e Shtimes, Gllogocit dhe Lipjanit në Kosovë, **Fatmir LIMAJ** dhe **Isak MUSLIU**, vetë dhe në bashkëpunim me forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e tyre, planifikuan, nxitën, urdhëruan, kryen, ose përndryshe ndihmuan planifikimin, përgatitjen ose kryerjen e krimeve të Burgosjes dhe Trajtimit Mizor të civilëve serbë dhe shqiptarë. **Fatmir LIMAJ** dhe **Isak MUSLIU** gjithashtu dinin ose kishte arsye që të dinin se krimet e Burgosjes dhe Trajtimit Mizor do të kryheshin ose ishin kryer nga ana e vartësve të vet, dhe nuk morën masa të domosdoshme dhe të arsyeshme për të parandaluar akte të tilla ose për të ndëshkuar kryesit e tyre. **Haradin BALA** kreu ose përndryshe ndihmoi në kryerjen e krimeve të Burgosjes dhe Trajtimit Mizor të civilëve serbë dhe shqiptarë.
22. Gjatë periudhës kohore të përmendur më sipër, forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e **Fatmir LIMAJT** zunë në mënyrë të paligjshme se paku tridhjetëepesë civilë serbë dhe shqiptarë nga komunat e Shtimes, Gllogocit dhe Lipjanit në Kosovë dhe i sollën me dhunë në Kamp-Burgun e Llapushnikut.

23. Në Kamp-Burgun e Llapushnikut, forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e **Fatmir LIMAJT** dhe **Isak MUSLIUT** mbajtën në mënyrë të paligjshme civile serbë dhe shqiptarë për periudha të gjata. Të burgosurit civilë shqiptarë u pyetën vazhdimisht për gjoja “bashkëpunim” me serbë, shpesh vetëm në bazë të kontakteve joushtarake me civilë serbë. **Fatmir LIMAJ, Isak MUSLIU**, dhe **Haradin BALA** morën pjesë personalisht në ruajtjen e të burgosurve në Kamp-Burgun e Llapushnikut dhe në marrjen në pyetje të të burgosurve.
24. Me këto veprime dhe mosveprime, **Fatmir LIMAJ, Isak MUSLIU dhe Haradin BALA**, dhe **Isak MUSLIU** morën pjesë në:

Pika 1: Burgosje, KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, i ndëshkueshëm në bazë të Neneve 5(e), 7(1) (**Fatmir LIMAJ, Haradin BALA, dhe Isak MUSLIU**) dhe 7(3) (**Fatmir LIMAJ dhe Isak MUSLIU**) të Statutit të Tribunalit.

Pika 2: Trajtim Mizor, SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, e përcaktuar nga Neni i Përbashkët 3(1)(a) të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, e ndëshkueshme sipas Neneve 3, 7(1) (**Fatmir LIMAJ, Isak MUSLIU dhe Haradin BALA**) dhe 7(3) (**Fatmir LIMAJ dhe Isak MUSLIU**) të Statutit të Tribunalit.

PIKAT 3 deri në 6 (TORTURË, VEPRIME ÇNJERËZORE, TRAJTIM MIZOR)

25. Prej ose rreth majit 1998 deri në ose rreth 26 korrik 1998 në Kamp-Burgun e Llapushnikut, **Fatmir LIMAJ** dhe **Isak MUSLIU** vetë dhe në bashkëpunim me forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e tyre, planifikuan, nxitën, urdhëruan, kryen, ose përndryshe ndihmuan në planifikimin, përgatitjen ose kryerjen e krimeve të Torturës, Veprimeve Çnjerëzore dhe Trajtimit Mizor të civilëve serbë dhe shqiptarë. **Fatmir LIMAJ** dhe **Isak MUSLIU** gjithashtu dinin ose kishin arsye që të dinin se krimet e Torturës dhe Trajtimit Mizor do të kryheshin ose ishin kryer nga ana e vartësve të vet, dhe nuk morën masa të domosdoshme dhe të arsyeshme për të parandaluar akte të tilla ose për të ndëshkuar kryesit e tyre. **Haradin BALA** kreu ose përndryshe ndihmoi në kryerjen e krimeve të Torturës dhe Trajtimit Mizor të civilëve serbë dhe shqiptarë.
26. Gjatë periudhës kohore të përmendur më sipër, forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e **Fatmir LIMAJT** dhe **Isak MUSLIUT** i mbajtën të burgosurit në Kamp-Burgun e Llapushnikut në kushte brutale dhe çnjerëzore, duke ushtruar ndaj tyre sulme fizike dhe psikologjike në mënyrë të përsëritur, duke përfshirë tortura dhe rrahje. **Fatmir LIMAJ, Isak MUSLIU, dhe Haradin BALA** morën pjesë në imponimin dhe mbajtjen e kushteve çnjerëzore në kamp, të cilat përfshinin ushqim dhe trajtim mjekësor të

panjaftueshëm, dhe morën pjesë ose ndihmuan në torturimin dhe rrahjen e të burgosurve.

27. Me këto veprime dhe mosveprime, **Fatmir LIMAJ, Isak MUSLIU** dhe **Haradin BALA** morën pjesë në:

Pika 3: Torturë, KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, i ndëshkueshëm sipas Neneve 5(f), 7(1) (**Fatmir LIMAJ, Isak MUSLIU, dhe Haradin BALA**) dhe 7(3) (**Fatmir LIMAJ dhe Isak MUSLIU**) të Statutit të Tribunalit.

Pika 4: Torturë, SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, e përcaktuar nga Neni i Përbashkët 3(1)(a) i Konventave të Gjenevës të vitit 1949, e ndëshkueshme sipas Neneve 3, 7(1) (**Fatmir LIMAJ, Isak MUSLIU dhe Haradin BALA**) dhe 7(3) (**Fatmir LIMAJ dhe Isak MUSLIU**) të Statutit të Tribunalit.

Pika 5: Veprime Çnjerëzore, KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, i ndëshkueshëm sipas Neneve 5(i), 7(i) (**Fatmir LIMAJ, Isak MUSLIU dhe Haradin BALA**) dhe 7(3) (**Fatmir LIMAJ dhe Isak MUSLIU**) të Statutit të Tribunalit.

Pika 6: Trajtim Mizor, SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, e përcaktuar nga Neni i Përbashkët 3(1)(a) të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, e ndëshkueshme sipas Neneve 3, 7(1) (**Fatmir LIMAJ, Isak MUSLIU dhe Haradin BALA, dhe Isak MUSLIU**) dhe 7(3) (**Fatmir LIMAJ dhe Isak MUSLIU**) të Statutit të Tribunalit.

PIKAT 7 deri në 8 (VRASJE)

28. Prej një date në ose rreth qershorit 1998 deri në 26 korrik 1998, **Fatmir LIMAJ** dhe **Isak MUSLIU**, individualisht dhe bashkërisht me forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e tyre, planifikuan, nxitën, urdhëruan, kryen, ose përndryshe ndihmuan në planifikimin, përgatitjen ose kryerjen e krimit të Vrasjes së civilëve serbë dhe shqiptarë. Në secilin prej rasteve të parashtruar më poshtë, **Fatmir LIMAJ** dhe **Isak MUSLIU** dinin ose kishin arsye që të dinin se krimi i Vrasjes do të kryhej ose ishte kryer nga ana e vartësve të tyre, dhe ata nuk morën masa të domosdoshme dhe të arsyeshme për të parandaluar akte të tilla për të ndëshkuar kryesit e tij. Në disa raste të përmendur në paragrafët 31 dhe 32 më poshtë **Haradin BALA** kreu ose përndryshe ndihmoi në kryerjen e krimit të Vrasjes së civilëve serbë dhe shqiptarë.
29. Më 12 qershor 1998 ose rreth kësaj date, forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e **Fatmir LIMAJT** dhe **Isak MUSLIUT** vranë Ajet GASHIN, një të burgosur prej Kamp-Burgut të Llapushnikut. **Isak MUSLIU** mori pjesë ose ndihmoi në vrasjen e Ajet GASHIT.
30. Në një datë pas 24 qershorit 1998 por para 26 korrikut 1998, forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e **Fatmir LIMAJT** dhe **Isak MUSLIUT** vranë

një numër të burgosurish serbë dhe shqiptarë, emrat e të cilëve jepen në Shtojcën I të kësaj aktakuze, në Kamp-Burgun e Llapushnikut.

31. Në një datë në ose rreth mesit të korrikut 1998, forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e **Fatmir LIMAJT** dhe **Isak MUSLIUT** rrahën, torturuan dhe vranë katër të burgosur serbë dhe shqiptarë në Kam-Burgun e Llapushnikut, emrat e të cilëve jepen në Shtojcën II të kësaj aktakuze. **Isak MUSLIU** dhe **Haradin BALA** morën pjesë ose ndihmuan në vrasjen e të katër burgosurve.
32. Në një datë në ose rreth qershorit ose korrikut 1998, forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e **Fatmir LIMAJT** dhe **Isak MUSLIUT** rrahën, torturuan dhe vranë Fehmi XHEMËN, i njohur si Fehmi TAFI, në Kamp-Burgun e Llapushnikut. **Isak MUSLIU** dhe **Haradin BALA** morën pjesë ose ndihmuan në vrasjen e Fehmi XHEMËS, i njohur si Fehmi TAFI.
33. Me këto veprime dhe mosveprime, **Fatmir LIMAJ**, **Isak MUSLIU** dhe **Haradin BALA** morën pjesë në:

Pika 7: Vrasje, KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, i ndëshkueshëm sipas Neneve 5(a), 7(1) (**Fatmir LIMAJ**, **Isak MUSLIU** dhe **Haradin BALA**) dhe 7(3) (**Fatmir LIMAJ** dhe **Isak MUSLIU**) të Statutit të Tribunalit.

Pika 8: Vrasje, SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, e përcaktuar nga Neni i Përbashkët 3(1)(a) i Konventave të Gjenezës të vitit 1949, e ndëshkueshme sipas Neneve 3, 7(1) (**Fatmir LIMAJ**, **Isak MUSLIU** dhe **Haradin BALA**) dhe 7(3) (**Fatmir LIMAJ** dhe **Isak MUSLIU**) të Statutit të Tribunalit.

PIKAT 9 deri në 10 (VRASJE)

34. Më 26 korrik 1998 ose rreth kësaj date, në malet e Berishës afër Kamp-Burgut të Llapushnikut, **Fatmir LIMAJ** dhe **Haradin BALA** vetë dhe në bashkëpunim me forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e **Fatmir LIMAJT**, planifikuan, nxitën, urdhëruan, kryen, ose përndryshe ndihmuan në planifikimin, përgatitjen ose kryerjen e krimit të Vrasjes së dhjetë të burgosurve shqiptarë. **Fatmir LIMAJ** gjithashtu dinte ose kishte arsye që të dinte se krimi i Vrasjes do të kryhej ose ishte kryer nga ana e vartësve të vet, dhe nuk mori masa të domosdoshme dhe të arsyeshme për të parandaluar akte të tilla ose të ndëshkonte kryesit e tyre.
35. Pak para 26 korrikut 1998, forcat serbe ripushtuan rrethinën e Kamp-Burgut të Llapushnikut. Si pasojë, më 26 korrik 1998, UÇK-ja e braktisi Kamp-Burgun e Llapushnikut dhe **Haradin BALA** dhe një rojë tjetër detyruan rreth njëzetën të burgosur të ecnin prej kampit në drejtim të maleve të Berishës. Gjatë rrugës, ata u takuan me **Fatmir LIMAJN**, i cili i dha urdhra **Haradin BALËS**.

36. Pak më vonë, **Haradin BALA** i ndau të burgosurit në dy grupe. Një grup prej rreth nëntë të burgosurish u lirua. Grupi tjetër prej rreth dymbëdhjetë të burgosurish u detyrua nga **Haradin BALA**, roja tjetër dhe një ushtar i tretë i UÇK-së të shkonte në një vend të hapur në pyll. Pastaj **Haradin BALA**, roja tjetër dhe një ushtar i tretë i UÇK-së i pushkatuan, duke vrarë dhjetë prej të burgosurve, emrat e të cilëve jepen në Shtojcën III të kësaj aktakuze.
37. Me këto veprime dhe mosveprime, **Fatmir LIMAJ** dhe **Haradin BALA** morën pjesë në:

Pika 9: Vrasje, KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, i ndëshkueshëm sipas Neneve 5(a), 7(1) (**Fatmir LIMAJ**, dhe **Haradin BALA**,) dhe 7(3) (**Fatmir LIMAJ**) të Statutit të Tribunalit.

Pika 10: Vrasje, SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, e përcaktuar nga Neni i Përbashkët 3(1)(a) i Konventave të Gjenezës të vitit 1949, e ndëshkueshme sipas Neneve 3, 7(1) (**Fatmir LIMAJ**, dhe **Haradin BALA**) dhe 7(3) (**Fatmir LIMAJ**) të Statutit të Tribunalit.

/nënshkruar në origjinal/
Carla Del Ponte
Prokurore
/Vula e Prokurorisë/

Sot, me datën 6 nëntor 2003.
Në Hagë
Holandë

SHTOJCA I

Paragrafi 30: Të burgosurit e vrarë midis 24 qershorit dhe 26 korrikut 1998 në Kamp-Burgun e Llapushnikut

Milovan KËRSTIQ
Miodrag KËRSTIQ
Slobodan MITROVIQ, i njohur si Boban
Miroslav SHULNIQ
Zhivorad KËRSTIQ
Stamen GENOV
Gjorgje ÇUK
Sinisha BLLAGOJEVIQ

SHTOJCA II

Paragrafi 31: Të burgosurit e vrarë në mes të korrikut 1998 në Kamp-Burgun e Llapushnikut

Jefta PETKOVIQ
Zvonko MARINKOVIQ
Agim ADEMI
Vesel AHMETI

SHTOJCA III

Paragrafi 36: Të burgosurit e vrarë në ose rreth 26 korrikut 1998 në ose rreth maleve të Berishës afër Kamp-Burgut të Llapushnikut

Emin EMINI

Ibush HAMZA

Hyzri HAJRIZI

Shaban HOTI

Hasan HOXHA

Safet HYSENAJ

Bashkim RASHITI

Hetem REXHAJ

Lutfi XHEMSHITI

Shyqyri ZYMERI